



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:239628  
Datë: 22.12.2022  
Numri i dokumentit: 03787795

C.nr.1/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Vushtrri – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtarin Naim Rekaliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, M. K. nga fshati P. komuna e V. te cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.Nexhat Beqiri nga Vushtrria kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “E.” me seli ne Prishtinë lidhur me Kompensimin e dëmit, ne seancën e datës 22.12.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET se është tërhequr padia me numër C.nr.1/2017 e paditësit, M. K. nga fshati P. komuna e V. kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” ne çështjen juridike të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidenti ne datës 03.10.2015.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi M. K. nga fshati P. komuna e V. te cilët sipas autorizimit i perfaqeson av.Nexhat Beqiri nga Vushtrria pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi, kundër paditures, Kompania e Sigurimeve “E.” lidhur me kompensimin e dëmit.

Gjykata ka caktuar seancë për datë 22.12.2022, në të cilën palët ndërgjyqëse, kanë qenë të ftuar nga procesverbali i datës 07.11.2022, ndërsa nuk kanë prezantuar asnjëra nga to, dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Meqenëse i autorizuari i paditësit nuk ka prezantuar ne seancë, gjykata konform nenit 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e konsideruar padinë e paditësit si te tërhequr, ndërsa për shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 463 par.1 te LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.1/2017, datë 22.12.2022

**Gj y q t a r i**  
Naim Rekaliu

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.